Kronikë

Tiranë/ Rrihte vazhdimisht gruan dhe mbante armë pa leje në banesë, në pranga 25-vjeçari

Një 25-vjeçar është vënë në pranga nga Policia e Tiranës, pasi dyshohet se ushtronte në mënyrë të vazhdueshme dhunë ndaj bashkëshortes së tij. Nga kontrolli i kryer në banesën e tij u gjertën edhe armë pa leje.

Armët që u gjetën në banesë e 25-vjeçarit

Redaksia
4 Shtator, 09:36 | **Përditesimi: 4 Shtator, 09:38**

Share

Një 25-vjeçar është vënë në pranga nga Policia e Tiranës, pasi dyshohet se ushtronte në mënyrë të vazhdueshme dhunë ndaj bashkëshortes së tij. Nga kontrolli i kryer në banesën e tij u gjertën edhe armë pa leje.

Njoftimi i policisë:

LEXO EDHE:
Vodhi paratë e kompanisë ku punonte, por bëri kallëzim të rremë, pranga 27-vjeçarit në Tiranë

"Shërbimet e Komisariatit të Policisë Nr. 1, pas informacioneve të siguruara për një shtetas që ushtronte dhunë të vazhdueshme ndaj bashkëshortes së tij, si dhe mbante armë zjarri në banesë, në Burrel, në bashkëpunim me shërbimet e Komisariatit të Policisë Mat, kanë organizuar dhe finalizuar operacionin policor të koduar "Bashkëpunimi".

Si rezultat, u bë arrestimi i shtetasit R. B., 25 vjeç, banues në Tiranë, për veprat penale "Dhuna në familje" dhe "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyese dhe i municionit".

25-vjeçari dyshohet se ka ushtruar në mënyrë të vazhdueshme dhunë ndaj bashkëshortes së tij. Gjatë kontrollit në banesën tjetër të këtij shtetasi, në fshatin Fullqet, Burrel, shërbimet e Komisariatit të Policisë Mat gjetën dhe sekuestruan në cilësinë e provës materiale 1 armë zjarri pistoletë, 1 pushkë sportive dhe 1 armë gjahu.

Materialet i kaluan Prokurorisë Tiranë, për veprime të mëtejshme procedurale", njofton policia.

Lajmi në përditësim...

M.T/Shqiptarja.com

TAG: arme pa leje | Dhune | Tirane

Komento

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:
Çfarë do të sjellë sesioni i ri parlamentar mes partive politike?

Bashkëpunim | Debat | S'e di

Lajme të tjera

VIDEO/ Qytetarit i kishte rënë bateria e makinës, Veliaj e ndihmon ta ndezë

3 Shtator, 18:29

Kamëz/ Plagosi me thikë të riun dhe u largua, arrestohet pas ndjekjes nga policia 33-vjeçari në Babrru

3 Shtator, 17:04

Shtrenjtohet qiraja në Tiranë, studentët e rinj mes stresit të akomodimit! 37 konvikte janë gati, më 4 shtator nis regjistrimi

Enxhi Musaj

3 Shtator, 15:54

Nxënës e mësues, rezultojnë shkaktarë dhune në shkolla! Gjatë 2022 u regjistruan 2750 raste dhune! Sociologu: Fenomenit mund t'i vihet fre përmes edukimit

Enxhi Musaj

3 Shtator, 15:45

'Kërkonte alkool, por s'na kërcënonte', shitësi i marketit për 37 vjeçaren e vrarë nga motra në Tiranë: Edhe i ati vdiq nga pija

3 Shtator, 15:29

VIDEO/ 'Të mbeta në dorë o Bekim', dalin pamjet e dhunës me shkop gome ndaj policit dhe vëllait të tij në Tiranë

3 Shtator, 14:26

Aksident me vdekje në Kamëz! Shoferi përplaset me një mjet, ndërron jetë pasagjerja 22-vjeçare

3 Shtator, 13:57

Shtrohet rruga 'Rexhep Bastari' te Fresku, Veliaj: Ky është mandati i zonave periferike në tiranë

3 Shtator, 12:07

U kapën me shkelje, dy shoferët tentojnë të korruptojnë policin me 50 euro! Vihen në hetim

3 Shtator, 10:53

Vodhën zyrën e një avokati, 3 në kërkim në Tiranë! Sekuestrohen 30 mijë euro

3 Shtator, 10:21

'Europa që nuk e dinit se ekzistonte'! Media greke rendit 9 vendet që duhen vizituar në Shqipëri

3 Shtator, 10:09

Tiranë/ Krim në familje, motra vret të motrën me thikë, u raportua si vdekje natyrale! Arrestohet autorja: Debatuam që të linte alkoolin, kërcënoi se do më vriste mua dhe nënën (EMRAT)

Sokol Dema

3 Shtator, 08:42

HOROSKOPI

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

© 2011 - 2023 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje